

Gropa silazhi ose balla silazhi? – Çfarë duhet të dimë?

Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe Aksioner i AUSTRIA Prämix shpk.



Gropat e reja të silazhit kanë nevojë për një bazament të padepërtueshëm nga uji. Lëngjet që dëmtojnë silazhin dhe ujrën e rreshjeve të ndotura nga mbetjet e silazhit nuk duhet të depërtojnë në bazament.

Personi përgjegjës që planifikon një gropë të re silazhi, duhet ta ndërtojë në mënyrë të tillë që sipërfaqja e prerjes të mos ndodhet në anën që preket nga rreshjet. Gropat e silazhit duhet të kenë një pjerrësi të lehtë në anën ku duhet të jetë sipërfaqja e prerjes dhe të jetë 7m e gjerë, me qëllim që silazhi të mund të ngjeshet njëkohësisht nga dy traktorë. Lartësia dhe gjerësia e masës së ushqimit duhet të jetë në atë masë që të garantohet marrja e masës ushqimore çdo ditë 20 cm, ndërsa në verë 30 deri në 35cm. Nëse gropa e silazhit ka mure anësore, atëherë masa e silazhuar mund të ngjeshet më mirë. Gjithsesi kapaciteti i masës që do depozitohet është më pak variabël. Një tendencë e mureve prej 5 deri në 10°, lehtëson ngjeshjen pa shkakuar humbje në masën e silazhuar gjatë marrjes. Lartësia e mureve anësor duhet të zgjidhet në atë mënyrë, që plasmasët të mund të kalojnë mbi mur, në rastin kur gropa e silazhit është mbushur plot.

Gropat e silazhit janë të predispozuara të kenë në masën e silazhuar acid laktik dhe citrik që dëmtojnë betonin. Si mbrojtje ndaj kësaj vepron një lyerje me llak për gropat e silazhit, të cilat duhen rinovuar vazhdimisht. Një mbrojtje sipërfaqësore me një shtresë me rrëshirë Epoxyd ka kosto të larta por ja vlen që të realizohet që në fillim, pasi më vonë bazamenti nuk do të ketë qëndrueshmërinë e duhur.



Rezistent në ndërtimin e gropave të silazhit është betoni që i reziston ngricës dhe kripës ndaj rrëshqitjes. Edhe asfalti pa përmbajtje katrani (kujdes me asfaltin e ricikluar!) është i përshtatshëm për aq kohë sa është përdorur asfalt i derdhur apo i petëzuar rezistent ndaj ujit. Asfalti është rezistent ndaj lëngjeve gërryese dhe mund të derdhet në sipërfaqe të mëdha pa lënë plasaritje. Por duke marrë parasysh kostot bazë, asfalti ja vlen të përdoret vetëm në gropa silazhi me një madhësi prej rreth 1000 m². Asfalti është i përshtatshëm edhe për rinovimin e shtresave të betonit. Në këtë rast duhet të jetë të paktën 8 cm i trashë. Garanci dhe rezistencë, ka dhënë përzierja e një lënde të lëmuar në një beton të thjeshtë. Sipërfaqja është e padepërtueshme nga uji dhe relativisht më e leverdisshme në çmim.

Silazhi me balla: të thjeshtë në presim dhe lidhje.

Ballat e silazhit janë vendosur prej një kohe të gjatë si alternativë e gropave të silazhit. Për më tepër, silazhi është më i thjeshtë për t'u tregtuar.

I vlerësuar në teknologjinë e silazhimit në balla është fleksibiliteti i lartë, kërkesa e ulët për investim në ndërtesa, magazina dhe përshtatja në parcela të vogla. Presuesit dhe korrëset kanë arritur një nivel të lartë, saqë është e mundur të përfitohen balla silazhi edhe në kushte të vështira. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që duhet të përpunohen foragjerë të papastër dhe të njomë ose sanë e cilësisë së ulët. Qëllimi duhet të jetë përftimi i ballave të ngjeshur mirë, me foragjerë të prerë shkurt dhe të mbështjellë mirë, në mënyrë që gjatë magazinimit të qëndrojnë në gjendje të mirë dhe të shpërndahet më lehtë.

Të presuara fort apo jo?

Nga dy sistemet e ndryshme të presimit të ballave të barit, në zonat klasike me sipërfaqe të gjelbërta dhe zonave malore, trendi shkon prej vitesh në drejtimin e sistemit të presimit të ballave në mënyrë konstante. Presat e lartëpërmendura prodhojnë balla bari të lidhura me metodën jo të presuara fort, janë shumë praktike në përdorim dhe kanë një jetëgjatësi maksimale. Sistemet e lidhjes së barit i presojnë ballat nëpërmjet zinxhirëve ose rripave. Ngjeshja bëhet gjatë gjithë procesit të shtypjes. Nga këto shtypëse formohen balla me diametër 0,6 deri në 1,8 m, e cila lejon një përdorim të gjithanshëm të sanës dhe kashtës.

Këshilla

Për presat e ballave të silazhit rekomandohen traktorët me fuqi të paktën 100 PS. E nevojshme për kompletimin e dhomës së presimit të silazhit janë krahët e mbledhësve të barit të njëtrajtshme me një gjatësi optimale nën 60 cm. Mbledhësja e barit duhet të punojë me lëvizje zig-zag (në intervale prej 10m). Në procesin e lidhjes së barit duhet të krijohet një ngjeshje sa më optimale në mënyrë që mos të depërtoje ajri. Për të testuar presimin e ballave përdoret metoda e grushtit: Balla e silazhit duhet të jetë nga të gjitha krahët njëlloj e presuar.

Prerja

Numri i thikave në makinën prerëse varet nga përdorimi. Me makinën prerëse mund të bëhen balla me dendësi deri në 15%. Në këtë mënyrë ballat janë më të lehtë për t'u hapur. Gjendja e thikave duhet të kontrollohet para çdo përdorimi. Thikat e makinës prerëse duhet të mirëmbahen rregullisht (sipas llojit të foragjerëve pas 50 deri në 100 balla) sepse thikat e pamprehura rrisin ndjeshëm kërkesën për energji dhe për karburant. Parimi bazë është: të mprehen rrallë por me një pajisje mprehëse të përshtatshme. Gjithashtu është e këshillueshme një set thikësh të dyta sepse koha e mprehjes së tyre është rreth 20 minuta.

Plastmas ambalazhimi

Për procesin e mbështjelljes, duhet të përdoret plastmas cilësor nga prodhues të njohur. Plastmasët e lirë, vjetërohen shpejt për shkak të rezistencës së dobët ndaj rrezeve diellore dhe në këtë mënyrë shkëputet procesi i ambalazhimit. Trashësia standarde e plastmasit 0,025 mm është për përdorim normal, nëse ajo mbështillet në gjashtë shtresa. Për sasi të mëdha ose për mbështjellje me katër shtresa, mund të përdoret plasmas me trashësi 0,035 mm.

Transporti i ballave

Dëmtimet e plasmasit duhet të shmangen gjatë transportit të ballave. Piruni që transporton ballat e silazhit nuk duhet të ketë asnjë cep të mprehtë. Ballat duhet të magazinohen në një vend pak të dukshëm dhe mundësisht në një vend fiks. Për të shmangur dëmtimet e plasmasit nga zogjtë, macet dhe kafshë të tjera, ballat duhet të mbulohen. Në rast se plasmasi dëmtohet, atëherë duhet ngjitur menjëherë me ngjitës të posaçëm.